



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 6 prill 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Selvije Halimi, Radmila Vujović dhe Mufera Şinik.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Petrit Hysaj - OSBE, Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Saranda... , Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 29 marsit 2010,
3. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
4. Përgatitja për tryezën e rumbullaket përkitazi me Projektligjin për Avokatin e Popullit, që do të mbahet më 16 prill 2010,
5. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 29 marsit 2010**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29 mars 2010, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

**Kryetari** - Njoftoi se e kishte kërkuar nga Kryesia e Kuvendit tërheqjen e propozimeve për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, sepse Shoqata e Juristëve e kishte dërguar propozimin, që të mos bëhen dy propozime të ndara. Tha se e keni propozimin që ka ardhur nga Shoqata e Juristëve. Kërkoi pëlqimin e anëtarëve që kandidati Rexhep Murati të përkrahet, sepse i plotëson kushtet ligjore.

*Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

### ***R e k o m a n d i m***

*Të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidatët:*

- 1. Fejzullah Hasani, Gjykata Supreme e Kosovës,*
- 2. Miodrag Paviq, Gjykata Supreme e Kosovës,*
- 3. Osman Ismaili, Fakulteti Juridik,*
- 4. Vesel Jashari, Prokuroria e Shtetit e Kosovës,*
- 5. Radica Miliq, Shoqata e Prokurorëve Publikë e Kosovës,*
- 6. Destan Rukiqi, Oda e Avokatëve e Kosovës,*
- 7. Elmaze Syla, Shoqata e Gjyqëtarëve e Kosovës,*
- 8. Rexhep Murati, Shoqata e Juristëve e Kosovës.*

## **4. Përgatitja për tryezën e rrumbullaket përkitazi me Projektligjin për Avokatin e Popullit, që do të mbahet më 16 prill 2010**

**Kryetari** - Propozoi që ky dëgjim të mbahet më 16 prill 2010, në orën 11:00, me sqarimet e dhëna nga administrata lidhur me propozimet për ekspertët e ftuar.

**Bajram Kosumi** - Propozoi që në dëgjim publik të ftohen: Zejnullah Gruda, Gjylbehare Murati, Qendra Rinore për të Drejtat e të Rinjve, Lubomir Todorovic, Hilmi Jashari, Enver Hasani, Ilirjana Islami, Ibrahim Asllani, Bashkim Ibishi dhe Qerim Qerimi. Për caktimin e ekspertëve, që do të angazhohen, do të vendosim pas këtij dëgjimi.

**Armen Zemaj** - Theksoi që grupi i ekspertëve të mos jetë më shumë se tri veta, ndërsa këta do të ishin njerëz të praktikës dhe që kanë përvojë për Avokatin e Popullit ose në fushën e të drejtave të njeriut.

**Kryetari** - Propozoi të ftohen përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, të Ministrisë së Drejtësisë, të KMDLNJ-së, të gjykatave, të Shoqatës së Juristëve, të Odës së Avokatëve, të Gjykatës

Kushtetuese, të organizatat joqeveritare, të OSBE-së, të Fakultetit Juridik, të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të Komisioni për Ndihmë Juridike, të Qendrës Rinore për të Drejtat e të Rinjve, të Shoqatës së Grave Juriste dhe të EULEX-it.

Ftesa të veçanta do t'u dërgohen z. Çukallovic, Ibrahim Asllanit, Bashkim Ibishit dhe Luljeta Domanikut.

**Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

### **PËRFUNDIM**

*Komisioni vendosi të mbajë dëgjim publik më 16 prill 2010, në orën 11:00.*

### **5. Të Ndryshme**

**Kryetari** - Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për faljen, kemi mbetur në këtë pikë për shkak të mosmarrëveshjes që e kemi pasur me Zyrën e Presidentit, si dhe me ndryshimet që janë bërë në Ministrinë e Drejtësisë. Ishte i mendimit se duhet të vazhdohet me përsëritjen procedurave, me caktimin e takimeve të radhës, përfshirë edhe vizitën e paraparë në burgun e Dubravës. Kërkoj nga administrata të kërkohet nga Zyra e Presidentit dhe nga Ministria e Drejtësisë ta caktojnë datën e vizitave të këtyre institucioneve.

**Kryetari** – Për grupin e punës, të caktuar për nxjerrjen e rekomandimeve lidhur me Raportin Agjencisë Kundër Korrupsionit, propozoi që grupi i punës të mbajë takim më 07. 04. 2010, në orën 10:00. Në pamundësi që të jetë Armend Zemaj, për shkak se është i angazhuar në grupin për shqyrtimin e P/L për ekzekutimin e sanksioneve penale, në vend të tij të jetë Adem Hajdaraj.

**Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

*Grupi i punës, i caktuar për shqyrtimin e raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, do të mbajë takim më 07. 04. 2010, në orën 10:00, në një nga sallat e Kuvendit.*

### **Njoftim rreth vizitës në Shqipëri**

Kryetari i njoftoi se Komisioni ka paraparë të realizohet një vizitë në Republikën e Shqipërisë dhe propozoi që vizita të bëhet më 21 - 25 prill 2010.

Meqë nuk pati vërejtje për datën e propozuar, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

### **PËRFUNDIM**

- I. *Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi vendosi që më 21 - 25 prill 2010 ta bëjë një vizitë zyrtare në Shqipëri.*
- II. *Komisioni do të mbajë takim me Komisionin e Ligjeve, me Avokatin e Popullit dhe me Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë.*
- III. *Komisioni kërkon nga Shërbimi i Protokollit të Kuvendit të Republikës Kosovës t'i aranzhojë takimet me institucionet e lartpërmendura.*

Mbledhja përfundoi në orën 15:20

**Përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Bahri Hyseni**